

LAHUTA, INSTRUMENT MUZIKOR AUTENTIK SHQIPTAR

Azgan **HAKLAJ**

Studiues, Akademia “Rrënjët Tona”

PËRMBLEDHJE

Përpara se ti përgjigjemi kësaj pyetje me logjikë të ftohtë e me deduksion të logjikës së paanshme historike duhet të themi dy fjalë për këtë instrument, magjik, bashkëudhëtar të iliro-dardano- arbërorëve dhe prej mijra vjetësh të këngëve epike të popullit shqiptar. Lahuta shqiptare është po aq e lashtë sa plisi i bardhë, xhamadani e xhubleta, simbole këto të alpeve tona. Areali i vjetër i Lahutës e aedeve të saj në lashtësi shtrihej në të gjitha vargmalet tona të banuara nga fiset ilire duke u shtrirë deri në Dalmacinë e epërme e në lindje deri në Bosnjen e sotme. Lahuta është instrumenti muzikor autentik shqiptar. Elementët me të cilët është e ndertuar e tregojnë vjetërsinë e saj. Mjafton një dru lisi për të gdhendur kokën e bishtin dhe një hark druri i tendosur me një copëz tel të hollë të përbërë me qime të bishtit të kalit, lekura e dhisë e tendosur dhe e mbërthyer mbi sipëfaqen zgavër të kokës së lahutës, e fiksuar mbi kunjat druri, që lahutari mjeshtër të prodhojë tingujt magjik. Nuk ka pasur nevojë aspak të presë epokën industriale për të dalë në dritë, si veglat tjera muzikore, siç janë violina, pianoja apo edhe çiftelia e sharkia, të cilat janë të reja në kohë.

Fjalë kyçe: Barbarë, troje, malësi, pushkë, trashëgimi kulturore, lahutë shqiptare.

ABSTRACT

Before answering this question with cold logic and deduction of impartial historical logic, we must say two words about this instrument, magical, companion of the Illyrian-Dardano-Arberians and for thousands of years of epic songs of the Albanian people. The Albanian lahuta is as ancient as the white fleece, the jamadani and the xhubleta, these symbols of our Alps. The ancient area of Lahuta and its aedes in antiquity stretched across all our mountain ranges inhabited by Illyrian tribes extending as far as Upper Dalmatia and east to present-day Bosnia. Lahuta is an authentic Albanian musical instrument. The elements with which it is built show its antiquity. An oak tree is enough to carve the head and tail, and a wooden bow stretched with a thin piece of wire composed of ponytail hair, the goat skin stretched and fastened over the hollow surface of the lahuta head, fixed on wooden pegs, for the master lahutari to produce magical sounds. There was no need at all to wait for the industrial age to come to light like other musical instruments such as violin, piano or even couplet and sharkia, which are new in time.

Key words: barbarian, lute, territories, highland, rifle

HYRJE

Elementët me të cilët përbëhet lahuta janë prezente në trojet tona të banuara prej mijra vitesh. Dihet se ilirët e pasardhësit e tyre e kanë patur të njohur mitin e lisit e gdhendësit e tyre ishin me famë që nga anijet liburne, zburimet e pallateve mbretërore, ikonastët e kishave e manastireve deri tek odat e burrave të malësisë dhe djepat e fëmijëve. Mjeshtër e gdhendës së drurit lanë pas një trashëgimi mahnitëse kulturore e simbolesh, nga epoka e paganizmit e deri tek ditët tona. Lahuta shqiptare është po aq, në mos më e vjetër se lira e Orfeut të Greqisë, e cila na vjen nëpër mugëtirën e shekujve. Tingujt e saj që shoqëruan këngët epike janë monument i pavdekshëm që shqiptarët u kanë ngritur prijësive të tyre. Veprat heroike janë përcjellë në breza me anë të aedeve tanë të cilët kanë mësuar përmendësh e transmetuar besnikërisht në breza. Është koha t’iu kujtojmë serbëve së nuk është faji i shqiptarëve që ardhacakët e stepave nuk kanë një epos kombëtar, siç e kanë shqiptarët Eposin e Kreshnikëve, Gjergj Elez Alinë, Lahutën e Malsisë dhe Fishtën, apo një Iliadë, siç e kanë grekët me Homerin. Epikologu Lambertz me origjinë (gjermano-austriake) pajtohet se këngët e Eposit të Kreshnikëve rrodhën në kohën

e dyndjeve të sllavëve nëpër Danubin e poshtëm dhe ruajnë ende kujtimin e luftërave të vjetra të shqiptarëve kundër sllavëve në vitet 700-800, të cilat shënojnë zanafillën e kalimit nga identiteti ilirik në identitetin arbërorë. Këto këngë janë eposet e fundit aktiv në Europë në fillim të mijëvjeçarit të ri që zunë vend në arealin e epikës botërore.

Folkloristi Qemal Haxhihasani na sjell studimin dhe promovimin në Suedi nga studiuesi Ullmar Ovick të nënciklit të Eposit të Kreshnikëve, Baladën e Gjergj Elez Alisë. Aleks Buda ka një kontribut të shquar në hulumtimin e Eposit të Kreshnikëve. Ai na rrëfen se keto këngë sjellin konfliktin e përgjakshëm të shqiptarëve me serbët rreth shekujve 6-7-të, pikërisht kur u shfaqën ata dhe kulmoi në shekujt 13-14, në kohën e forcimit të pushtetit feudal qendror të nemanjicëve. Studiuesi, babai i folklorit “Nderi i Kombit” Ramadan Sokoli shprehet se: “Vegla muzikore si lahuta, e cila përfaqëson tipin e hershëm të veglave kordafone me hark përdoren nga popuj të largët dhe të afërm. Të tilla janë “revanstroni” i Indisë, “kobizi” i Kazakistanit” ”hixhaku” i Uzbekistanit dhe Armenisë, “komisi” i Kirgizisë, “uhr-sieni” i Kinës, “rebabi” i Arabisë, “cerevali” i Etiopisë, “gusla” e Serbisë Jugore, ”lira” e disa krahinave të Greqisë, apo ”lirica” e Maqedonisë dhe Bullgarisë. Por, kjo nuk të thotë se ato kanë të njëjtat shprehje muzikore dhe të njëjtën moshë. Historikisht dihet se kultura e vjetër egjiptiano- asiro-babilonase-greko-romake nuk ka pasur vegla muzikore me hark. Studimet muzikologjike më të përparuara e kanë flakur tezën antihistorike të prejardhjes së veglave kordofone me hark nga Skandinavia apo India dhe kanë provuar me argumente se prejardhja e tyre është nga lindja e mesme dhe kryesisht nga Persia. Deri në fillim të shek. të 19^{te}, kur studiuesi autodidakt Vuk Karaxhiçi, njeri prej themeluesve të shtetit serb, me një penel pule dhe barut përgatiti një penë dhe bëri një përmbledhje të këngëve popullore serbe, kultura serbe nuk njihej fare. Ai punoi me moton: “Kudo ku gjendet një serb i vetëm, aty duhet të gjej vend shteti Serb”. Por ky shtet nuk përfaqësonte asgjë më shumë se një tribu dhe nuk kishte arritur të tërhiqte vëmendjen e asnjë studiuesi serioz evropian.

Sipas Ramadan Sokolit, Eposi i Kreshnikëve është dokumentuar qysh në vitet 1300, pra, rreth 500 vjet përë se të kujtohej Karaxhiçi. Eposi shqiptar i Kreshnikëve, ky monument madhështor i kulturës së kombit tonë do të ishte pa lahutën, si predha pa detonatorin, apo avioni pa karburant. Ky epos lindi për të përjetësuar qëndresën e kreshnikëve shqiptarë në betejat me hordhitë serbo-sllave, krajlët, kapedanët e vojvodët e tyre gjakatarë. Lahuta jonë është, jo vetëm pjesë e ADN-së dhe e lashtësisë, por tashmë përfaqëson një emblemë të kulturës, folklorit dhe etnosit, me të cilën identifikohemi para botës së civilizuar dhe kontributin e pamohueshëm në kulturën e popujve.

Ajo është institucioni i kuvendimit të shqiptarëve me Zotin.

Me lahutë është kenduar Teuta e Genti, Milloshi - princi i Drenicës që i preu kokën Sulltan Muratit, Gjergj Kastrioti (Skënderbeu) e Lekë Dukagjini, Nora e Kelmendit, Oso Kuka, Zhuj Selmani, Ali Pashë Gucia, Jakup Ferri, Mic Sokoli, Sef Kosharja, Ded Gjo’ Luli, Bajram Curri, Isa Boleini, Hasan Prishtina, Azem Galica, Çun Mula, Prek Cali dhe luanët e maleve që ranë gjatë shekujve në betejat për liri. Me këtë lahutë luftoi për çlirimin e trojeve shqiptare nga pushtuesit deri në Gur t’Shpuem (në Nish) Hyjnori, “Nderi i Kombit” Dervish Luzha, i vetmi luftëtar i Luftës së Dytë Botërore pa pushkë, por me shkop e lahutë. Populli i këndon sot duke e apostrofuar ”Luftoi Baca deri n’Gur t’Shpuem”. Sot dhe gjithë ditën në kurorën e alpeve shqiptare nga Vermoshi në Bjeshkët e Nemuna, në Majat e Shalës, në Nikaj- Mertur, Rugovë, në Shkëlzen dhe në Bjeshkët e Rrafshit të Dukagjinit, lahuta rri e varur krenare në Odën e miqve e tingujt e saj ushtojnë brez pas brezi. Nuk është rastësi që poeti ynë kombëtarë Gjergj Fishta, i cilësuar Homeri Shqiptar, kryeveprën e tij epike e ka pagëzuar ”Lahuta e Malsisë”. Kjo ka ndodhur jo vetëm për faktin se betejat më të përgjakshme me turqit dhe sllavët janë zhvilluar në arealin, ku lahuta zë kryet e vendit, por edhe për faktin kokëfortë se përmes lahutës shqiptare është ruajtur e përcjellë

mrekullisht, brez pas brezi, jeta e zakonet shqiptare, mitologjia, e drejta zakonore dhe betejat e përgjakshme për liri. Në vitet 1920-1924, studiuesit francezkan At Bernardin Palaj e Donalt Kurti i ranë, pashë me pashë, veriut të alpeve shqiptare dhe mblodhën nga goja e rapsodëve ciklin e mrekullueshëm të Eposit të Kreshnikëve i cilësuar me të drejtë krahas trashëgimisë ilire, Kanunit të Lekë Dukagjinit dhe Epokës së Gjergj Kastriotit, si kuarteti i shenjtë i trashëgimisë historike-kulturore-juridike të Kombit shqiptar. Të ndriturit Palaj dhe Kurti u ekzekutuan me urdhër të Beogradit në vitin 1946 nga diktatura komuniste e instaluar me dhunë, por ata lanë një vepër të pavdekshme në dobi të Atdheut tonë. Albanologia ruse "Agni Desnikcaja" e ka vlerësuar Palajn si njohësi më i mirë i alpeve. Në vitin 2016, ai shpallet shenjtor. Pa lahutë nuk ka epos, e kjo është aksiomë që nuk ka nevojë për vertetim. Do ta veçoj rapsodin Sokol Martini, i cili dinte 10,000 vargje përmendësh nga Eposi i Kreshnikëve. Kjo pohon të vertetën historike se ky rapsod shqiptar i lindur në zemër të alpeve e ka trashëguar nga të parët e tij rapsodë të tjerë këtë margaritar të rrallë të kulturës shqiptare, por edhe të mbarë njerëzimit. Këngët e lahutës nuk ishin vetëm përjetësim i bëmave historike dhe heronjëve të tyre, por dhe edhe një "adrenalinë" e fuqishme për trimat shqiptarë në prag të betejave homerike. Kur Oso Kuka sheh në endër hijen e vdekjes që endet në Vraninë, një natë para betejës shfarosëse të hordhive malazeze, ngrihet në këmbë e ju drejtohet trimave të tij: *Merr Kaçel njëherë lahutën / E na thuaj një këngë shqiptare / Se shqiptarët nga lufta nuk tuten / Se nuk mbajmë zi pa dal fare*".

Asnjë poet në botë nuk ka arritur të skalisë në vargje bukurinë femërore, siç e kanë gdhendur të parët tanë portretin e Tanushës së krajlit serb. Po të ngrihej nga varri anonimi gjenial i vargjeve do të bërtiste në kupë të qiellit: *Mos ma prek barbar lahutën!?* Ku është Shteti Shqiptar? Ku është Akademia e Shkencave? Ku është Instituti i Kulturës Popullore? Ku është Ministria e Kulturës? Ku janë studiuesit e intelektualët që janë mburrur me studimet e tyre? Pse janë strukur? Pse po heshtin përpara këtij fallsifikimi skandaloz të historisë? Po sjell në vemendje festivalin folklorik të Gjirokastrës të vitit 2015. Ansambli i qarkut të Kukësit me grupin e valltarëve të Malësisë së Gjakovës interpretoi me mjeshtri të lartë artistike - Kcimi i kreshnikëve në logun e zanave", pra solli pikërisht Eposin e Kreshnikëve, shoqëruar me vajtimin e thekshëm të Ajkunës për të birin Omerin: *Tu shoftë drita ty moj hanë / Që s'ma çove një fjalë mbramë / N'lugje t'verdha për me dalë / E me hy nj'i vorr me djalë / Çou Omer e luaj me zana / Se ty vorrin ta ruan nana*"

Duke qenë se edhe numrat e tjerë ishin të spikatur, juria e festivalit mendonte për çmimin e parë, por në mënyre brutale, me hakmarrje politike e përjashtuan nga çdo çmim. Kjo është lehtësisht e verifikueshme, nëse i referohemi arkivit të festivalit folklorik të Gjirokastrës, maj 2015. UNESCO ka pranuar si pjesë të saj Luginën e Lumit të Gashit, por nuk pranon Eposin e Kreshnikëve që kanë jetuar në këtë luginë. Vajtimi i Ajkunës ka ndodhur vetëm pak kilometra larg Luginës së Gashit, në hyrje të Grykës së Dragobisië, në fshatin Këlcyrë, ku sot nuk kendojnë zogitë, as qyqja, për shkak të mallkimit të Ajkunës për vdekjen e të birit Omerit. Dylyftimi i Gjergj Elez Alisë me bajlozin e detit ka ndodhur në fshatin Mejdan, rrëzë Malit Shkëlzen që ngrihet madhështor përballë Luginës së Gashi, i cili është qendra e Shqipërisë Etnike. Në shpatet e tij janë të arkivuara dylyftimet e Mujt dhe Halilit me krajlitë serbe. A janë të njëjta qendrimet e Ministrisë së Kulturës?! Tani nuk ka medyshje. Ministria e Kulturës e ka sabotuar edhe Eposin e Kreshnikëve, edhe lahutën si shpirt të tij. Barbarët e jugut grekët na grabitën historinë, udhëheqësit shqiptarë të pavarësisë së tyre i përzunë vellezërit çamë nga trojet e tyre duke i masakruar rrugës. Kërkojnë të na marrin detin dhe të asgjesojnë Kauzën Çame në bisedime të fshehta. Grabitën fustanellën. Njëpërmjet agjentëve të tyre kulturorë asgjësuan rrugëtimin e Polifonisë për në Unesco duke e zëvendësuar me Iso -polifoninë. Barbarët e veriut, serbët penguan pranimin në Unesco të Eposit të Kreshnikëve, tani na grabitën lahutën. Ata që fallsifikuan historinë në betejën e Fushë Kosovës të vitit 1389 po shtrembërojnë dhe historinë e kulturës shqiptare dhe Eposin e Kreshnikëve që duhet të jetë në Unesco përkrah me eposet e Gilgameshit, Vedave Indiane, Dioskurëve të Greqisë,

Nibelungëve të Gjermanisë, Këngëve të Rolandit të Francës dhe të Sidit të Spanjës. Po e mbyll këtë refleksion duke perifrastuar vargjet e poetit Hamit Aliaj Mjeshter i Madh, interpretuar nga këngëtarja brilante Fatmira Breçani - Mjeshter i Madh: *“Mos ma shaj barbar lahutën / Se unë kurrë s’e kam dasht luftën / S’kam dashtë kangë me luftë e gjak / Deri mu çel vorri në prag / S’kam dasht’ kangë me plumba e shpata / Por ka shkoj unë nuk pata / Ditë për ditë ma kan djeg shpin’ / N’bark të nanës m’kan pre femin / Veç perball jo s’u ndala / Për liri djalit e fala / I të gjithëve është ky qiell / Gjithkush ka një hise diell / E kam dhanë bukën e krypen / Permas shpine m’kan fut thikën / Edhe shkronjat n’abetare / Gjak pikojnë e janë plot varre / N’male t’mia plot me dritë / Thonë banojnë o perenditë / Jam rrit’ bashk me perendi / Nuk due luftë po due liri”*.

Serbët rrëmbyen lahutën, Irani po grabit çiftelinë, grekët po vjedhin llautën, malazezët synojnë përvetësimin e xhubletës. Sllavët po përpiqen të marrin Eposin e Kreshnikëve. Çfarë na mbetet neve? Ku janë strukur institucionet shtetërore? Qeveria Shqiptare në vend që të marrë masa e të hartojë një strategji pashqiptare për mbrojtjen e tyre rrënoi vetë teatrin kombëtar dhe me anë të qendrës kombëtare të veprimtarive folklorike promovon buzukun gjatë pandemisë si trashëgimi greke. Kjo situatë imponon platformë emergjente pashqiptare për mbrojtjen e identitetit kombëtar. Është krijuar një panoramë tragjikomike në dyert e Uneskos. Hienat pansllave e neotomane pasi kanë ndërmarrë një sulm të akorduar kundër simboleve kombëtare janë turrur për të rrëmbyer trashëgiminë shpirtërore, pasuritë kulturore shqiptare të mbetur pa Zot. Qeveria Shqiptare në vend që të hartojë një platformë pashqiptare për mbrojtjen e tyre bëhet vetë pjesë e ketyre skenarëve ogurzi. Me rrulat e talebanëve të saj e shembi vetë tempullin e artit, shtëpinë e artistëve, rrënoi identitetin kulturorë, me qëllimin keqdashës, asgjësimin e memories kombëtare, kurse për grabitjen e trashëgimisë kulturore hesht në mënyrë të paturpshme. Akademitë e shkencave të Shqipërisë dhe Kosovës nuk reagojnë, Instituti i Kulturës Popullore nuk prononcohet, Ministrinë e kulturës të Shqipërisë dhe Kosovës janë inekzistente, madje Ministria e Kulturës së Shqipërisë në mënyrë paradoksale, duke shfrytëzuar pandeminë, promovoj buzukun si trashëgimi kulturore greke.

Unioni Artistik i Kombit “Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut”, nderuar me “Medaljen Gjergj Kastrioti”, dënon me forcë këtë platformë të akorduar pansllave – neotomane, sulmin ndaj simboleve kombëtare, grabitjen dhe përvetësimin nëpërmjet Uneskos të instrumentëve muzikorë shqiptarë, synimin e rrembimit të Eposit të Kreshnikëve, asgjësimin e identitetit kulturor, zhbërjen e historisë kombëtare, njëkohësisht bën thirrje për hartimin e një programi dhe strategjie pashqiptare për mbrojtjen e identitetit kombëtar.

Po pse jemi në këtë situatë?

Është krejt e thjeshtë për tu përgjigjur? Sipas përcaktimit filozofik kemi kombe dinastike, politike, kulturore. Kombi ynë futet tek kombet kulturore, sepse akoma nuk është shtet komb, i cili në fakt do të ishte e vetmja zgjidhje që garanton stabilitet e paqe në rajon. Folklori është ADN-ja e tij, engjëlli mbrojtës, pashaporta e identitetit të rrugëtimit përmes mugëtirës së shekujve, në kalvarin e gjatë për të mbijetuar. Profeti Muhamet na ka lënë një postulat: “jetëgjatësia e një populli varet nga jetëgjatësia e kulturës tradicionale të tij”. Mbijetesa jonë gjatë odisesë kristiane, kulturës tradicionale i dedikohet. Por është shumë e dhimbshme dhe e turpshme që po na i marrin armët e mbijetesës një nga një, për shkak të mbetjes pa përkujdesje, pa mbrojtje nga qeveria e institucionet përkatëse. Qeveria nuk ka asnjë projekt mbrojtës, biles nuk ka investuar aspak në këtë fushë, përkundrazi ka deshmuar se për shkak të utilitetit për pushtet ka sakrifikuar të gjitha asetet kombëtare, pasuritë strategjike. Në mungesë të përfeksionimit, përsosjes dhe paisjes me teknologji të instrumentëve muzikorë folklorikë, për shkak të lenies pas dore, me dashje të Ministrisë së Kulturës së Shqipërisë, Shqipërinë e jugut e ka pushtuar buzuku, të cilin qendra kombëtare e veprimtarive folklorike vazhdon ta propagandojë si trashëgimi kulturore greke,

ndërsa Shqipërinë e veriut e kanë pushtuar sazet turke. Erdogani ndryshe nga ekspeditat pushtuese me luftë të Mehmet pushtuesit, po përdorë si strategji ekspeditat ekonomike rajonale në formë ndihme dhe ekspansionin kulturorë për ringritjen e Perandorisë Otomane, duke imituar e shpresuar kështu në suksesin që pati arritur pushtimi hollivudian i viteve 70^{te} në fundshekullin e 20-të. Për këtë vershim neootoman në rajon janë shqetësuar edhe fuqitë e mëdha perëndimore. Llautën që e përdorin shqiptarët si mjet folklorik nga veriu i Shqipërisë, në Çamëri deri në Kalabri, kanë nisur punën për ta regjistruar si trashëgimi kulturore të tyren grekët në Unesco. Malazetët synojnë ta përvetësojnë xhubletën shqiptare mijëra vjeçare. Nuk jemi çuditur pse sllavoserbët nuk kanë bërë këkesë për ta rrëmbyer plisin e bardhë e xhamadanin. Jo aspak. Sepse shpresojnë t'i marrin bashkë me Eposin e Kreshnikëve.

E çfarë na mbetet neve?

Çitianet e dajës producent, Sulltan Ramës dhe Guruja i Damian Gjikhurit. Po dashur të bëj kasandrën me hamendësi, përtej mendimeve hipotetike, po i referohemi dhe analizojmë me logjikë të ftohtë faktin e kryer. Në dhjetorin e vitit të kaluar Irani u grabiti çiftelinë shqiptarëve, duke e regjistruar atë në Unesco si trashëgimi të vehten. Ku është Ministria e Kulturës? Ku janë institucionet shqiptare? Ku janë strukturat? Pse heshtin? E shitën çiftelinë njësoj si Lahutën? Është tepër e rëndë, dramatike dhe komike njëkohësisht. Shqiptarëve u është grabitur instrumenti bazë prej nga janë krijuar të gjithë instrumentët e tjerë me tela, ndërsa Ministria e Kulturës dhe institucionet përgjegjëse heshtin, bëjnë të paditurin.

Sigurisht do të mjaftohen me deklarata qesharake, ashtu sikur bënë për lahutën. Natyrshëm shtrohen pyetjet:

1. A na mori Irani çiftelinë?
2. Kujt i përket ajo?

Për t'u dhënë përgjigje këtyre pyetjeve duhet shpjeguar kuptimi etimologjik i çiftelisë, e për këtë na vjen në ndihmë gjuha jonë e bukur shqipe, e cila gëzon statusin e 10-të gjuhëve më të vjetra të botës. E këne bërë edhe të tjerë ndonjë shpjegim para meje, por unë po përpiqem të bëj interpretime linguistike shtërruese të emrave të instrumentëve muzikorë folklorikë kordanofonë që nuk mund të shpjegohen në asnjë gjuhë tjetër veçse në gjuhën shqipe. Vetë emri çifteli tregon pagëzimin e një instrumenti me dy korda. Ky emërtim ka filluar të përdoret atëherë kur teknologjia e ka bërë të mundur pajisjen e kësaj vegle me korda metalike. Po si u grabiti Irani çiftelisë shqiptarëve dhe si e regjistroj si trashëgimi iraniane? Sepse përdori në regjistrim emrin e vjetër të saj, duter por persisht, dotar do – tar (dy tela). Për ta kuptuar më mirë lojën me emërtimin duhet të shpjegojmë kuptimin etimologjik të emrit “Duter”. Duter fjalë për fjalë përkthehet në shqip dy ter, dy tjerr, të tjerra, pra dy fije, sepse në lashtësi kordat e instrumentëve muzikorë bëheshin me qimet e tjerra të kafshëve, por ata përdorën fjalën persishte dotar dy tela. Është lehtësisht e kuptueshme se telat janë shumë më të vonë në kohë se kordat prej leshi, prandaj vetëkuptohet pa asnjë ekuivok se ata kanë marrë çiftelinë tonë. Meqenëse çiftelia është instrumenti bazë nga janë krijuar të gjithë instrumenët e tjerë kordanofonë po i analizoj me radhë, një nga një.

Në Ballkan është i njohur edhe buzuku, i cili është shumë i vonë në kohë, me të cilin është unifikuar kultura greke, pasi ua mori shqiptarëve, ku në fakt për turpin e saj qendra kombëtare e veprimtarive folklorike si të tillë e promovoj edhe sëfundmi gjatë pandemisë. E theksoj me forcë këtë fakt, sepse emri buzuk ka vetëm një shpjegim, shqip, buzë- ujku. Dihet që ujku lëshon një zë të madh, ulurimë të zgjatur, po ashtu edhe buzuku ka një tingull të fortë, të tejzgjatur si hungurima e tij. Në kohërat e herëshme kordat bëheshin me leshin e ujkut. Buzuku nuk ka asnjë shpjegim në gjuhën greke. Turqit i kanë vendosur emër tjetër, dyzen, që shqip do të thotë dy zëra.

Ndërsa mandolina me katër çifte telash shqip do të thotë, "ma nep dollinë". Të gjithë studiuesit janë në një mendim unik se buzuku është përsosje e tambures. Tamburja është pranuar në mënyrë aksiomatrike, botërisht se është modifikimi i duterit, çiftelisë duke i shtuar një tel, kurse buzuku është krijuar shekuj më vonë, pas tambures, e cila është vertetuar katërcipërisht se është trashëgimi e të parëve tanë, i cili është përsosur në vijimësi. Buzuku me tetë tela, katër çifte është krijim i shekullit të 20-të. Tamburja do të thotë "Ta mburja" të mbajnë burrat. Ajo ka qënë vegël vetëm për meshkuj, sepse për femrat kishte vegël tjetër, "Pandora", pa në dorë, mban në dorë, në kuti. Kështu shpjegohen të gjithë emrat me radhë të veglave me shumë tela, psh emri i vjetër "harpa" përkthehet qafëharp, kuptimi i të cilës vjen nga harku i gjuetarëve. Edhe harpa vjen nga "Lyra", lira, ylli, poli i veriut. Romakët e quajnë timpan, persët zuraja, arabët asanja, etimologjikisht përkthehen "t'i mban", "zu- un-ra-ja", "a - shaja - është shenja".

Vetë Orfeu i famshëm përkthehet rrefëj. Në shkrimet që kam trajtuar lahutën e kam quajtur si institucioni i kuvendit me Zotin.

Për të vertetuar si e kanë grabitur serbët atë e shoh të arsyeshme ti referohem edhe njëherë kuptimit etimologjik të emrit të saj, lahutë, e cila nënkupton e do të thotë lutë, të flasësh me perendinë, shkurt lutje perëndisë për fat, mbarësi, pra ajo ishte instrument i shoqërimit të ngjarjeve të jetës njerëzore. Të gjithë studiuesit prestigjozë janë të një mendje se lahuta është instrumenti me i vjetër në botë dhe kanë dalë me përfundimin shtërrues se violina e sotme është përsosmëria e saj. E risolla edhe njëherë në vëmendjen e publikut lahutën, sepse edhe gusla e pranuar në Unesco si trashëgimi kulturore serbe është shumë e vonë, biles variant kroatë, të cilët janë pasardhës të fisit ilirë të dalmatëve që u asimiluan nga sllavët. Shpjegimi etimologjik i gusle-s është "gisht që i bie instrumentit dhe gushë, sepse violina mbështetet në gushë, poshtë mjekrës. Strategjia e serbëve ka qënë e hollë, në fillim kanë marrë guslën, variant kroat dhe pastaj do të hidhen në sulm për Eposin e Kreshnikëve të Jutbinës, meqenëse Jutbina, që ata e thërrasin Udbine, ndodhet rreth 50 km në veriperëndim të Zarës në Kroaci, do të mundohen të luajnë me vendodhjen e saj në territorin e zaptuar atëkohë prej krajlive e zhupanëve të tyre. Megjithëse të gjitha faktet historike janë kundër sllavo-serbëve, Eposi është në rrezik e kërkohet reagim emergjent, unik, panshqiptar për ta mbrojtur trashëgiminë tonë kulturore të shtrenjtë e të shenjtë.

Ai është në rrezik. Studiuesi Ramadan Sokoli "Nderi i Kombit" thotë se Eposi është dokumentuar qysh në vitin 1350 afër 4-5 shekuj pa dalë në skenë Vuk "UK" Karaxhiqi - shqiptari nga Bosnja, i ortodoksizuar, i cili krijoi folklorin serbë e kushtetutën serbe. Arbëreshet e Zarës, të themeluar nga fisi ilir i liburnëve që u kanë rezistuar rrebesheve të historisë erozionit të kohërave, asimilimit që nga perandoritë e zhupanëve serbë, mbretëritë sllave, ustashëve e udbashëve, janë dëshmia kokëfortë e pakundërshtueshme, se aty janë rrënjët ilire. Vetë gusla është ilire dhe Eposi i Kreshnikëve është shqiptar. Për të vertetuar këtë pohim po rikthehem edhe njëherë tek Jutbina. Jutbina është qendra kryesore e kreshnikëve. Ajo është urëkalimi nga identiteti fisnor ilirë në identitetin e ri, atë arbërorë. Ky zhvillim ndodhi pas përballjes me pushtuesit barbarë serbë në shekullin e 7-të, të cilët u përqëndruan rreth lumit Sava, ku u konsoliduan e krijuan edhe mbretëritë e tyre me në krye krajlët. Gjatë këtyre betejave të kreshnikëve me krajlitë serbe u krijuan këngët epike. Shqiptarët arbërorë u zhvendosën në bjeshkët e nemuna, për t'u mbrojtur nga sulmet e barbarëve, por arbërorët u detyruan të ikin edhe nga Jutbina, veçse Eposin e morën me vehte. Ata që kanë qëndruar aty janë asimiluar.

E kam shpjeguar në shkrimet e mëparshme se dylyftimet dhe mejdanet e kreshnikëve me krajlitë serbe vazhduan edhe në territorin e Dardanisë Alpine, Malësisë së Gjskovës. Ajkuna e vajtoj Omerin në Grykën e Valbonës e Omeri e ka varrin në bjeshkët e Koshares. Fshati Mejdan rrëzë Malit të Shkelzenit e ka marrë këtë emër nga dylyftimet e Mujit e Halilit me krajlitë serbe dhe Gjergj Elez Alisë me bajlozët e detit sipas gojëdhënave. Një tjetër instrument muzikorë me korda, modifikim i çiftelisë, është

'sharkia', por shumë, shumë e vonë, në shekujt 17-18-të. Kuptimi etimologjik i saj do të thotë "çfarë kie çfarë ke". Edhe ky instrument muzikorë përdorej për të shoqëruar ngjarjet e jetës. Shpjegimi etimologjik i emrave të instrumentëve folklorikë bazikë të trashëgimisë kulturore shqiptare, verteton se ka një platformë akord sllavo – neotomane për grabitjen e saj.

PËRFUNDIME

1. Dy nga instrumentat bazë të identitetit kulturorë shqiptar lahuta dhe çiftelia janë rrëmbyer nga serbët dhe Irani, ndërsa buzuku është dhuruar vetë nga Ministria e Kulturës Shqiptare, kurse lahuta po grabitet nga grekët.
2. Le të shpresojmë që fondacioni Prek Cali do ta shpëtojë xhubletën mijëra vjeçare nga përvetësimi i malazezëve. Por e apostrofoj edhe njëherë se qëllimi kryesor i sllavëve është përvetësimi i Eposit të Kreshnikëve. E pasi ta marrin eposin, e marrin edhe plisin e bardhë, edhe xhamadanin. Ata shpresojnë shumë, se pasi kanë përjashtuar lahutën shqiptare dhe e kanë bërë pjesë të Uneskos guslën e kanë shumë të kollajtë për ta marrë Eposin, pasi e kanë marrë shpirtin e tij, lahutën. Ata janë kujdesur herët, qysh pas Luftës së Dytë Botërore për ta shpopulluar krejtësisht zonën e Jutbinës dhe rreth saj nga popullsia kroate.
3. Gjatë luftërave të kroatëve me serbët në kohën e shpërbërjes së Jugosllavisë, Jutbina është dëmtuar shumë rëndë deri sa e kanë marrë forcat kroate në vitin 1995. Sllavët mendojnë se kanë zhdukur çdo gjurmë aty, prandaj po luftojnë me çdo çmim për ta përvetësuar Eposin tonë legjendarë.
4. Kjo situatë kërkon urgjentisht një platformë kombëtare panshqiptare, për mbrojtjen e simboleve kombëtare dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore shqiptare e identitetin kombëtar. Duhet të reagojnë me shpejtësi rrufe ministritë e kulturës të Shqipërisë dhe Kosovës, akademitë e shkencave shqiptare, Instituti i Kulturës Popullore, studiuesit, akademikët, artistët, shoqatat kulturore, meqenëse Unesko nuk ka marrë vendim për Eposin e Kreshnikëve. Unioni Artistik i Kombit Shqiptar lëshon kushtrimin.
5. Në këmbë për të shpëtuar trashëgimisë kulturore dhe identitetin kombëtar. E lëshojmë këtë kushtrim sot në ditën e kuvendit të katërt të Akademisë Rrenjët Tona. Pikërisht në ditën Kuvendit të Lezhës të organizuar nga prijësit arbëror me në krye Gjergj Kastriotin simbolit kombëtar e shtetëror, arkitektit të shtetit me bazë nacionale, që sot quhet shteti komb ju bëjmë thirrje për të jetësuar mesazhin e thuprave të tij kur ai po kalonte në amshim. Bashkë.
6. Në këmbë për të mbrojtur identitetin e sovranitetin kombëtar. Bashkimi bën fuqinë e fuqia drejtësinë për kauzën tonë hyjnore shekullore.
7. Asgjë nuk mund ta ndalë finalizimin e ëndrrës tonë nacionale, bashkimin kombëtar e shtetin komb, me çifteli e pa çifteli, me lahutë e pa lahutë, me buzuk e pa buzuk.
8. Çamëria është shqiptare qysh në agim të historisë dhe e tillë do të jetë përjetësisht.

STUDIME MBËSHTETËSE DHE REFERENCA

1. Studiuesi Ramadan Sokoli
2. Epikologu Lambertz (gjermano-austriak)
3. Aleks Buda anëtar i Akademisë së Shkencave
4. At Bernardin Palaj studiues, shenjtor
5. Donat Kurti studiues
6. Gjergj Fishta poet, shkrimtar, studiues
7. Ullmar Ovick studiues suedez
8. Qemal Haxhihasani studiues
9. Agni Desnikcaja albanologe ruse

10. Hamit Aliaj poet, shkrimtar Mjeshter i Madh